



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
TIRANË

NR.REGJ.THEM.1

DATE REGJISTRIMI 01.03.2018

NUMER VENDIMI 9/11

DATA 28.03.2018

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANË, E PERBERE NGA:

MARINELA OSMANI – GJYQTARE

Sot me date 28.03.2018, mori ne shqyrtim kerkesen, qe i perket:

**KERKUES:** “Federata Shqiptare e Futbollit”, person juridik shqiptar, me seli ne Tirane, Adresa: Rruga e Elbasanit, Nr.9, perrfaqesuar nga Presidenti Armando Duka, dhe me autorizimin date 28.02.2018 nga Av.Aldi Topçiu dhe me autorizimin date 10.03.2018 nga Av.Julian Mertiri.

**OBJEKTI:** Depozitimin e vendimeve te Asamblese se Pergjithshme te FSHF-se, te dates 07.02.2018.

**BAZA LIGJORE:** Kodi Civil, Ligji Nr.8788, date 07.05.2001 “Per organizatat jofitimpruese”, Ligji Nr.8789, date 07.05.2001 “Per regjistrimin e organizatave jofitimpruese”.

**Gjykata,** ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te kerkeses;

V E R E N

1. Me kerkesen drejtuar kesaj Gjykate, kerkuesi Federata Shqiptare e Futbollit, kerkon regjistrimin ne regjistrin e personave juridike, prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, te vendimeve te Asamblese se Pergjithshme te FSHF-se, te dates 07.02.2018.

2. Pala kerkuese eshte regjistruar ne formen e personit juridik jofitimprues, me vendimin Nr.9, date 31.07.2001 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane. Ne baze te nenit 3 te ligjit Nr.9376, datë 21.4.2005 “Per Sportin” dhe pas shfuqizimit te tij, te ligjit Nr.79/2017, date 27.04.2017 “Per Sportin”, Federata Sportive parashikohet se është person juridik privat, që krijohet në



formën e shoqatës, anëtarë të së cilës janë shoqatat sportive, shoqëritë sportive dhe klubet sportive, që ushtrojnë veprimtari në një sport të caktuar. Ky nen është reflektuar në nenin 1 të Statutit, ku parashikohet shprehimisht: "1. Federata Shqiptare e Futbollit është person juridik, e cila përfaqëson bashkimin vullnetar të shoqatave dhe klubeve sportive të futbollit në Republikën e Shqipërisë, të cilat veprojnë në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, Ligjit Nr.8789, datë 27.05.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", Ligjit Nr.9376, datë 21.04.2005 "Për Sportin", dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që drejtojnë këtë aktivitet...".

3. Rezulton se në datë 07.02.2018 është mbledhur Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të Federatës Shqiptare të Futbollit (në vendim referuar FSHF), e cila ka marrë disa vendime, për të cilën pala kerkuese pretendon depozitimin, siç janë miratimi i përberjes së Komisionit të Verifikimit të Asamblese, miratimi i Komisionit të Verifikimit të Asamblese, Komisioni i Verifikimit të procesverbalit, zgjedhja e presidentit të FSHF, zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv etj.

**Në lidhje me parashikimet ligjore dhe statutores në lidhje me kërkesën objekt gjykimi, kjo Gjykatë duhet të ketë në konsideratë parashikimet si vijon:**

4. Sipas ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", në nenin 10 pika 1/3 parashikohet se: "Organi më i lartë drejtues i organizatës jofitimprurëse me anëtarësi është mbledhja e përgjithshme ose asambleja e të gjithë anëtarëve të saj. Organet e tjera drejtuese zgjidhen dhe përgjigjen përpara këtij organi më të lartë". Në bazë të nenëve 44 dhe 45 të Kodit Civil parashikohet se mbledhja e përgjithshme e anëtarëve ose e përfaqësuesve të tyre, është organi më i lartë i shoqatës. Ajo thirret nga organi drejtues, sipas dispozitave përkatëse të statutit, si dhe kur e kërkon një e pesta e anëtarëve. Mbledhja e përgjithshme vendos për pranimin ose përjashtimin e anëtarëve dhe për çdo çështje tjetër, që nuk është lënë në kompetencën e ndonjë organi tjetër të shoqatës.

5. Në vijim, në nenin 4 të Statutit parashikohen kategoritë e anëtarëve. FSHF mund të ketë anëtarë vetëm subjekte që janë njohur dhe regjistruar si të tillë nga organet kompetente shtetërore që përcakton legjislacioni në fuqi. Statutet dhe aktet themelore të këtyre subjekteve duhet të jenë në çdo rast në përputhje me këtë Statut dhe rregulloret apo aktet e tjera të FSHF-se.

6. Në lidhje me anëtarësimin, në nenin 7 parashikohet se: "1. Asambleja e Përgjithshme e FSHF-së është i vetmi organ që ka të drejtë të pranojë një aplikant si anëtarin e ri të FSHF-së. 2. Midis dy Asambleve të Përgjithshme, Komiteti Ekzekutiv i FSHF-së mund t'i japë anëtarësim provizor një kandidati, i cili përmbush të gjitha kërkesat statutores përcaktuar në Nenin 5 si më sipër."



7. Ne nenin 21 te Statutit parashikohet emërimi i delegatëve ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme. Keshtu: "1. Anëtarët emërojnë delegatët e tyre zyrtarë të autorizuar për t'i përfaqësuar ata, në përputhje me Statutet e tyre. 2. Delegatët zyrtarë duhet të jenë të pajisur me një prokurë të dhënë nga organi i tyre i autorizuar. Ata gjithashtu duhet të kenë evidencë për ta provuar këtë ashtu si kërkohet sikurse edhe provë për identitetin personal të tyre. 3. Anëtarët janë të detyruar të dërgojnë listën e emrave të delegatëve të tyre në Sekretariatit e Përgjithshëm të FSHF jo më vonë se 20 ditë para datës së zhvillimit të asamblesë."

8. Ne nenin 22 te Statutit percaktohet se: "2. Aktualisht FSHF ka 66 anëtarë. Lista e anëtarëve është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e FSHF. Ndryshimi i numrit të anëtarëve bëhet sipas rregullave të përcaktuara në statut.", ndersa ne nenin 27 parashikohet se Asambleja e Përgjithshme (e zakonshme ose e jashtëzakonshme) mund të marrë vendime të vlefshme vetëm kur shumica absolute 50 %+1 e të gjithë anëtarëve të FSHF përfaqësohet nga delegatë të caktuar posaçërisht.

9. Statuti ne nenin 30 parashikon se: "1. Zgjedhjet bëhen në mënyrë të fshehtë. Në qoftë se numri i kandidatëve është i barabartë me numrin vakant, zgjedhjet mund të bëhen duke ngritur dorën. 2. Asambleja e Përgjithshme zgjedh sipas radhës që vijon dhe me zgjedhje të lira: a. Presidentin e FSHF; b. Anëtarët që mbeten të Komitetit Ekzekutiv; c. Anëtarët e Komisionit Verifikues 3. Gjatë zgjedhjes së parë, Presidenti ka nevojë për 2/3 e votave të vlefshme me qëllim që të zgjidhet sipas rregullave. Në rastet kur asnjë nga kandidatët nuk arrin këtë shumicë, bëhet një round i dytë zgjedhjesh midis dy kandidatëve që kanë marrë më shumë vota në roundin e parë. Në roundin e dytë, kandidati që merr më shumë vota zgjidhet President. Në rastet e votave të barabarta, votimi do të përsëritet. Nëqoftëse edhe votimi i dytë përfundon me rezultat të barabartë, vendimi merret nëpërmjet hedhjes së shortit nga Sekretari i Përgjithshëm dhe monitoruar nga Komisioni i Verifikimit. 4. Zgjedhja e anëtarëve të mbetur të Komitetit Ekzekutiv dhe anëtarët e Komisionit të Verifikimit letra e zgjedhjeve konsiston në një list të të gjithë kandidatëve (në rend alfabetik). Kandidati zgjidhet në roundin e parë nëse mbështetet nga një shumicë absolute e votave të vlefshme (p.sh 50% + një votë). Në qoftë se nuk ka kandidatë të mjaftueshëm që arrijnë një shumicë absolute për të mbushur vendet bosh, organizohet raundi i dytë për të cilin një shumicë e thjeshtë (me të shumtat e votave) mjafton për një kandidat që të zgjidhet. Në rast barazimi bëhet raundi i tretë për të cilin mjafton një shumicë e thjeshtë. Në rastin e një barazimi të mëtejshëm, rezultati i zgjedhjeve përcaktohet nëpërmjet hedhjes së shortit nga Sekretari i Përgjithshëm."

10. Neni 59 i Statutit parashikon miratimin dhe datën e hyrjes në fuqi : "1. Ky Statut u aprovua nga Asambleja e Përgjithshme, e mbajtur në 9 Qershor 2007 në Durrës. Ato zëvendësojnë tërësisht çdo Statut të mëparshëm të FSHF. 2. Statuti hyn në fuqi kur rregjistrohet në gjykatën civile të Tiranës."

11. Statuti ka parashikuar dhe dispozita të përkohshme: "2. Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, do të ketë një rivlerësim të kërkesave statutores të domosdoshme për të gjithë anëtarët aktual të



FSHF-së. Ata kanë nevojë të adoptojnë formën ligjore në përputhje me Ligjin për Sportin. Veç kësaj ata duhet të përputhen plotësisht me Nenin 5 dhe duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentet e nevojshme brenda afatit të përcaktuar nga KE dhe për tu ndjekur nga Sekretariati. Mbas vlerësimit të këtyre kërkesave Sekretariati i Përgjithshëm i rekomandon KE të rikonfirmoj statusin e anëtarësimit. Nëse KE refuzon të japë rikonfirmimin, anëtari aktual i FSHF-së mundet të apeloj në Asamblenë e Përgjithshme, e cila merr vendimin përfundimtar për anëtarësimin.”

12. Ne nenin 31 të ligjit Nr.8789, datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurese” parashikohen regjistrimet në kolona të ndryshme. Kështu: “Regjistrimet në kolona të ndryshme të skedës së Regjistrimit bëhen si më poshtë: .....4. Në kolonën 4: regjistrime të tjera si: a) data e nënshkrimit dhe e miratimit të statutit; b) dispozitat e statutit që lidhen me kohëzgjatjen e organizatës; c) kompetencat e përfaqësimit të organeve drejtuese ose të likuiduesve; ç) ndryshimet në përbërjen e anëtarëve të organeve drejtuese ose të likuiduesve; ç) ndryshimet në përbërjen e anëtarëve të organeve drejtuese ose likuiduesve, si dhe çdo ndryshim në kompetencat e përfaqësimit të njërit prej këtyre personave; d) emrat, mbiemrat, vendlindjet dhe datëlindjet e themeluesve, të anëtarëve të organizatës, si dhe ndryshimet e tyre; dh) emrat, mbiemrat, datëlindjet dhe vlera e kontributeve pasurore të fondit themelues (nëse ka të tilla); e) çdo ndryshim i statutit. ....”.

Ne përfundim të analizës së ligjit, statutit dhe kërkesës objekt shqyrtimi, Gjykata verë se:

13. Bashkëlidhur kërkesës për depozitim nga ana e pales kerkuese janë paraqitur procesverbali i mbledhjes së Asambleës së Përgjithshme të Anëtarëve të FSHF-së, të datës 07.02.2018 si dhe 11 vendimet e pretenduara të marra në këtë mbledhje, të nënshkruara nga Presidenti i FSHF-së, Armand Duka.

14. Në nenin 24 të ligjit të ligjit Nr.8789, datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurese”, parashikohet se kur në rastin kur gjatë shqyrtimit të kërkesës dhe të dokumentacionit të bashkëlidhur, gjyqtari verë se përmbajtja e tyre nuk është e plotë, pasi thërret dhe dëgjon kërkuuesin, vendos për çështjet që duhen plotësuar, duke caktuar edhe një afat të arsyeshëm për plotësimin e tyre.

15. Në veprimet paraprake të shqyrtimit të kësaj çështje, Gjykata ka konstatuar se kërkesa e paraqitur nuk përmban të gjitha elementët e nevojshëm procedural civil për të vazhduar me tej shqyrtimin e saj. Për këtë arsye vendosi caktimin e një sance për degjimin e kërkuarit dhe përcaktimin e çështjeve që duhet të plotësohen prej tij.

16. Kështu, me vendimin e ndërmjetëm të datës 12.03.2018, nga ana e Gjykatës, pales kerkuese iu caktua një afat i arsyeshëm deri në datë 26.03.2018, për plotësimin e akteve si vijon:



**Se pari:** Paraqitja e nje liste te anetareve te Federates, duke percaktuar vendimet e depozitimit te ndryshimeve ne anetaresi, sipas informacionit qe duhet te merret nga Zyra e Regjistrat apo pranimi i aneteresise sipas vendimmarrjeve te Federates, duke paraqitur keto vendime. Percaktimi i numrit te pergjithshem te anetareve te FSHF-se paraqitet i domosdoshem, me qellim verifikimin e kuoromit te nevojshme per marrjen e vendimeve te vlefshme, detyre kjo e Gjykates ne baze te ligjit. Sipas nenit 24/2 te ligjit Nr.8788, date 07.05.2001 "Per organizatat jofitimpruese", parashikohet shprehimisht se organi me i larte vendimmarrës mblidhet me pjesëmarrjen e më shumë se gjysmës së anëtarëve të tij.

**Se dyti:** Per te gjithë personat juridike, shoqeri apo shoqata, anetare te Federates, kerkuesi duhet te paraqiste ekstraktet nga regjistrat publike te kohes (ose dhe me pas ne kohe) te leshimit te aktit te perfaqesimit, per delegatet pjesemarres ne mbledhjen e dates 07.02.2018, nga Qendra Kombetare te Biznesit apo Zyra e Regjistrat te OJF, prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane. Paraqitja e tyre eshte e domosdoshme per te vleresuar personalitetin juridik te anetareve (nese ato vijojne te kene zotesi juridike per te vepruar) dhe per te verifikuar organet e autorizuara per leshimin e aktit te perfaqesimit te delegatit per ne asamblene e pergjithshme, ne baze te ligjit dhe Statutit.

17. Ne date 26.09.2018, nga ana e pales kerkuese u paraqiten ne Zyren e Protokollit me Nr.821, dokumentacioni i pretenduar prej saj, i kerkuar nga Gjykata sipas vendimit te ndermjetem te dates 12.03.2018. Nga verifikimi i ketyre akteve rezultoi se:

**Se pari** – Nuk jane paraqitur asnje nga vendimet e Asamblese se Pergjithshme te FSHF-se, te depozituara ose jo ne Zyren e Regjistrat te Gjykates, me te cilat ajo ka vendosur per pranimin e anetareve te rinj, ne baze te ligjit dhe statutit, pas anetareve themelues.

**Se dyti** – Nje pjese e ekstrakteve te marre nga regjistrat publike nuk i perkasin kohes se leshimit te akteve te perfaqesimit te delegateve per ne mbledhjen e dates 07.02.2018 dhe nuk krijojne siguri ne lidhje me detyren e Gjykates per te verifikuar saktesisht te drejten e delegatit per te votuar ne emer dhe per llogari te anetarit te FSHF-se dhe te drejten e leshuesit te aktit te perfaqesimit per te leshuar kete akt, ne cilesine e organit drejtues apo perfaqesues te personit juridik, shoqate apo shoqeri. Ne rast te mungeses se ketyre akteve ne praktiken e mbledhjes, pala kerkuese mund te permbushte kete detyre, duke marre, gjate kohes se dhene nga Gjykata si afat nga data 12.03.2018, ekstrakte te thjeshta apo historike nga Qendra Kombetare e Biznesit, si dhe vertetime te leshuara nga Zyra e Regjistrat, qe provojne ekzistencen dhe autoritetin e organeve apo perfaqesuesve qe kane leshuar aktet e perfaqesimit per delegatet.

18. Nga sa me lart, nga ana e Gjykates arrihet në përfundimin se paraqitja e ketyre akteve, si me lart ciftuar, konsiderohet si ne veprim procedural i domosdoshem, per nje vendimmarrje te drejte nga ana e Gjykates. Mungesa e tyre ben te pamundur marrjen e nje vendimi nga Gjykata dhe si rrjedhoje, kërkesa paraqitur dhe aktet bashkelidhur duhet të kthehen me të meta, bazuar kjo në nenin 154/a parag. 4 të Kodit te Procedures Civile, në të cilin parashikohet shprehimisht



se: "Kur kerkesepadia (kerkesa) nuk i ploteson kushtet e permendura ne kete kre, Gjyqtari i vetem ia kthen paditesit (kerkuesit) ne kohën e paraqitjes se saj .....

### PER KETO ARSYE

Ne baze te nenitt 24 te ligjit te ligjit Nr.8789, date 07.05.2001 "Per regjistrimin e organizatave jofitimpruese" dhe nenit 154/a e vijues te Kodit te Procedures Civile, Gjykata;

### V E N D O S I

1. Kthimin e kerkeses pales kerkuese Federata Shqiptare e Futbollit.
2. Shpenzimet gjyqesore jane ne ngarkim te pales kerkuese.
3. Kundër këtij vendimi nga pala kerkuese mund të bëhet ankim i veçante ne Gjykatën e Apelit Tirane, brenda 5 ditëve nga dita e neserme e njoftimit te vendimit te arsyetuar.

*U shpall sot ne Tirane, me date 28.03.2018*